

# STATUTI I KOMUNËS

## Kuvendi i Komunës së Dragashit

Në bazë të mandatit të dhënë kuvendve të komunave të Republikës së Kosovës , me anë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, i cili ligj është bazë për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në tërë teritorin e shtetit tonë, duke pasur për bazë zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Kuvendit Komunës dhe kryetarëve të komunave, Kuvendi i Komunës së Dragashit, me datë 11.09.2008, miraton ndryshimet në (statutin) e Komunës, siç është përcaktuar në nenin 12.2 dhe 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

### PJESA I

#### KAPITULLI I : DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

Statuti i Komunës, është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me nenin 12 pika 3 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Statuti rregullon organizimin e brendshëm të komunës. Në përdorimin e mëtutjeshëm do të njihet si “Statuti i Komunës”.

##### Neni 2

Përgjegjësitë e Komunës ushtrohen, organizohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e komunës, në pajtueshmëri me Statutin e komunës dhe Rregulloren e Punës, të miratuar nga Kuvendi Komunës.

##### Neni 3

3.1 Statuti i Komunës zbatohet vetëm brenda kufijëve të Komunës së Dragashit .

3.2 Komuna mund të delegojë përgjegjësitë e saja tek komunat tjera, apo të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunat tjera ,në pajtueshmëri me Ligjin në fuqi, për çeshtje me interes të përbashkët.

##### Neni 4

Organet e komunës janë:

4.1 .Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i Komunës dhe

4.2 Kyetari i Komunës është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës

## Neni 5

5.1 Komuna ushtron përgjegjësitë të cilat nuk janë të rezervuara shprehimisht me ligj të institucionve qendrore.

5.2 Komuna ka cilësin e personit juridik.

5.3 Selia e Komunës është në Dragash dhe ndodhet në rrugën “Dëshmorët e Kombit”.

## Neni 6

### Gjuhët dhe simbolet

6.1 Për mbarëvajtjen e aktiviteteve zyrtare ,Komuna do të implementoj plotësisht politikën gjuhësore,siç është theksuar me Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve.

6.2 Gjuhë zyrtare në Komunën e Dragashit janë: gjuha Shqipe,Serbe dhe Boshnjake..

6.3 Komuna ka Emblemen e vetë. Përmbajtja dhe përdorimi i Emblemës do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës,i nxjerr në pajtim me aktet ligjore në fuqi të cilat e rregullojnë këtë lëmi.

6.4 Asnjë subjekt dhe person tjetër përveç Komunës nuk mund ta përdorë Emblemën dhe shenjat komunale apo simbolet pa autorizim paraprak të dhënë nga organet kompetente komunale.

6.5 Komuna e ka vulën e vetë. Mënyra e mbajtjes dhe udhëheqjes së vulave do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit Komunës i nxjerrur në pajtim me aktet ligjore në fuqi të cilat rregullojnë këtë fushë.

## Neni 7

### Dita e Çlirimit

7.1 Komuna ka Ditën e Çlirimit 15 (pesëmbëdhjetë)Qershorin,të cilën e feston çdo vit,duke mbajtur mbledhje solemne,në të cilën do të përkuqtojnë në mënyrë madhështore,heronjët,dëshmorët e UÇK-së dhe viktimat e luftës, si dhe Ditën e Dëshmorëve - 4 Majin.

7.2 Komuna për çdo vit feston festat kombëtare,shtetërore dhe fetare.

PJESA E DYTË  
PROCEDURAT PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË STATUTIT  
TË KOMUNËS

Neni 8

8.1 Iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës ndërmirret nga:

- a) Kryetari i Komunës
- b) Një e treta (1/3) e antarëve të Kuvendit Komunal
- c) Me iniciativen e 15% qytetarëve me të drejtë vote në Komunë

8.2 Propozimi për ndryshimin e statutit komunal dërgohet tek Kuvendi i Komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i Komunës ,para shqyrtimit final, duhet ta konsultoj publikun në lidhje me atë propozim.

8.3 Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, Kuvendi Komunal vendos se a do ta miratoj Statutin me ndryshime, pas shqyrtimeve të të gjitha vërejtjeve të marra.

8.4.Çdo propozim për ndryshimin e Statutit të Komunës miratohet në Kuvendin e Komunës,ashtu siç përcaktohet në nenin 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale

PJESA TRETË :

FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

Neni 9

Territori i komunës është përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave. Komuna e Dragashit përfshin qytezën e Dragashit dhe është e përbërë prej këtyre vendbanimeve: *Baqë, Bellobrad , Blaç, Bresanë, Brezne, Brod, Brrut, Buçe, Buzez, Dikancë, Gllloboqicë, Kapre, Kosavë, Kërstec, Krushevë, Kuk, Kukajan, Kuklibeg, Leshtan, Lybevisht, Mlikë, Orqushë, Pllajnik, Pllavë, Radeshë, Rapçë, Restelicë, Rrenc, Shajne, Vraniq, Xërxe, . Zaplluxhe, Zgatar, Zlipotok dhe Zym.*

MARRËDHËNIET ME FSHATRAT DHE VENDBANIMET

Neni 10

10.1 Për të siguruar plotësimin e të gjitha nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësive nga autoritetet lokale ,sa më afër qytetarëve, Komuna përmes Kuvendit të Komunës apo Kryetarit të Komunës vendos të delegoj kompetencat e veta administrative

10.2 Kuvendi i Komunës përcakton aktivitetet që mund t'i ushtrojnë fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane,e që janë në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të komunës.

10.3 Kuvendi i Komunës për këto njësi siguron ndarjen e resurseve nga Komuna ,që janë në perpjestim me përgjegjësit dhe aktivitetet e përcaktuara.

10.4 Për shtrirjen edhe më tej të përgjegjësive të përcaktuara me ligj ,Komuna mund të krijoj Zyra Komunale Informuse,apo sherbyese për të ofruar shërbime më pran qytetarve të saj.

10.5Komuna mban kontrollin e plotë të secilës fushë të kompetences së saj të de-koncentruar.

10.6 Zyra Komunale që do të funksionoj në kuadër të Komunës,që do të kriohet në secilen pjes (zonë) zyrat Komunale (ofiçarit) janë :

1. Zyra Komunale e Gjendjes Civile në Dragash, e cila u ofron shërbime këtyre fshatrave: Shajne, Radeshë, Lubovishtë, Leshtan, Rapçë, Krstec, Orqushë, Xërxe, Kukaljan, Vraniq, Mlik, Dikancë dhe Backë

2. Zyra Komunale e Gjendjes Civile në fshatin Bresanë, e cila u ofron shërbime këtyre fshatrave: Kuklibeg, Kuk, Kosavë, Pllajnik, Zaplluxhe, Buzez, Zgatar, Blac.

3. Zyra Komunale e Gjendjes Civile në Llapushnik, e cila u ofron shërbime këtyre fshatrave: Brezne, Buçe, Pllavë, Rrenc, Zym, Bellobrad, Brrut, Kapre.

4. Zyra Komunale e Gjendjes Civile në Krushe, e cila u ofron shërbime këtyre fshatrave: Zlipotok, Glloboqicë, Restelicë.

5. Zyra Komunale e Gjendjes Civile në Brod.

#### Neni 11

Zyra komunale do të kryej detyrat e mëposhtme:

Të gjitha detyrat dhe punët të cilat janë të shënuara në Ligjet mbi Regjistrat e Gjendjes Civile dhe aktet tjera nënligjore me të cilat rregullohet gjendja civile.

#### Neni 12

**ZYRA KOMUNALE ËSHTË PJES E ADMINISTRATËS DHE DREJTOHET  
NGA PERSONELI I CILI ËSHTË ZGJEDHUR SIPAS LIGJIT MBI SHËRBIMIN  
CIVIL NGA KOMUNA. PËR USHTRIMIN E DETYRAVE TË SAJ, ZYRA MARRË  
FONDET E NEVOJSHME NGA DREJTORATI PËRKATËS.**

#### PJESA E IV:

#### KONSULTIMET DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT

#### KAPITULLI –I- KONSULTIMET ME PUBLIKUN

#### Neni 13

13.1 Komuna konsulton publikun në mënyrë që të sigurojë që vendimet e marra janë të bazuara fuqishëm në fakte, dhe që janë marrë parasysh pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve si dhe që janë përdorur mundësitë e reja dhe kreative para marrjes së vendimit, si dhe që të gjitha vendimet e propozuara mund të implementohen efektivisht në praktikë.

13.2 Komuna ,gjithashtu , të siguron që qytetarët të kanë mundësi ta shprehin mendimin e tyre dhe se interesat dhe kërkesat e tyre janë marrë parasysh.

#### Neni 14

Komuna mund të shfrytëzoj secilën nga format e konsultimit të shënuara më poshtë (si dhe format tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave):

1. Fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale;
2. Kontaktet me grupet e caktuara, për t'i testuar dhe diskutuar politikën;
3. Anketat për implementimin e politikës, përfshirë përveç të tjerave informues kyç, klientë dhe qytetarë të prekur nga kjo politikë.
4. Shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft rregulloret, duke thirrur për pjesëmarrje në prezantime;
5. Kontaktet me grupet e interesit dhe mbledhjet me grupet e interesit;
6. Takimet publike;
7. Dëgjimet publike;
8. Studimet për vlerësim të efektit;

#### Neni 15

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës dhe Komitetet e Kuvendit të Komunës kanë autoritetin të mbajn konsullta publike, për çdo çështje që janë në kompetencën e tyre.

#### Neni 16

Në secilin rast duhet të jepet një arsyetim për mbajtjen e konsultave me publikun. Mënyra e cila shfrytëzohet për mbajtjen e konsultave me publikun duhet të publikohet 14 ditë përpara dhe duhet të lejohet kohë e duhur për përgatitjen e prezantimeve. Rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh dhe duhet të bëhen publike para se të merret vendimi.

#### Neni 17

17.1 Të gjitha komunikimet në lidhje me konsultimet duhet të jenë të qarta, dhe duhet të përfshijnë të gjitha informatat e nevojshme për t'i lehtësuar përgjigjet. Një dokument konsultues duhet të përfshijë një përmbledhje, prej dy faqesh më së shumti, të çështjeve dhe të pyetjeve kryesore për të cilat janë kërkuar mendimet e tyre; do të jetë më e lehtë për lexuesit të përgjigjen, të kontaktojnë apo të ankohen.

17.2 Kur përcaktohen grupet e caktuara në procesin e konsultimit, Komuna duhet të siguroj që palët relevante kanë mundësi t'i shprehin mendimet e tyre.

#### Neni 18

Komuna siguron publicitetin e duhur dhe duhet t'i adoptoj kanalet komunikuese në mënyrë që të përmbushë synimet e audiencës. Pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit, konsultat e hapura për publikun që duhet të publikohen në internet, në faqen zyrtare të Komunës.

#### Neni 19

Komuna i lejon publikut kohë të mjaftueshme, për shqyrtimin e përgjigjeve dhe kontributeve me shkrim. Komuna duhet t'i lejojë për marrjen e përgjigjeve me shkrim për konsultimin e publikut, brenda 8 javësh..

#### Neni 20

Përgjigjet duhet të analizohen dhe rezultatet duhet të bëhen publike, duke iu kushtuar rëndësi mendimeve të shprehura në marrjen përfundimtare të vendimit. Rezultatet e konsultave të hapura me publikun duhet të vendosen në faqen zyrtare të Komunës.

### KAPITULLI –II-: TUBIMET ME PUBLIKUN

#### Neni 21

21.1 Takimet me publikun mbahen në një sallë që është e mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Komuna duhet të mbajë së paku dy takime me publikun çdo vit, një në gjashtë mujorin e parë dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë .

21.2 Përveç kësaj, takimet tjera me publikun mund të mbahen, duke marrë parasysh se duhet të ekzistoj një interval prej dy muaj ndërmjet dy takimeve.

#### Neni 22

22.1 Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik duhet të shpallen ,së paku ,dy jave para mbajtjes së takimit. Takimet publike duhet të mos mbahen në datat apo kohën që në përgjithësi nuk është e përshtatshme për pjesëmarrjen e komuniteteve të veçanta.

22.2 Përfaqësuesit e mediave duhet të lejohen të marrin pjesë në të gjitha takimet me publikun.

#### Neni 23

23.1 Kryetari i Komunës apo përfaqësuesit e tij/saj, duhet ta kryesojnë mbledhjen me publikun. Ai/ajo duhet ta ketë autoritetin ta përcaktojë procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë mbledhjes si dhe ka autoritetin të mos lejoj diskutimin për disa çështje të caktuara që nuk janë të lidhura me çështjen e diskutuara apo që nuk janë në kuadër të pushtetit të komunës ose edhe nuk kanë të bëjnë me punët e komunës.

23.2 Ai/ajo mund të vendosë të mos i dëgjojë folësit të cilët prezantojnë pikëpamje të njëjta apo i përsërisin ato dhe mund të përcaktojë një limit kohor për kohën të cilën e kanë në dispozicion folësit.

#### Neni 24

Nëse bëhet një pyetje në takim publik, që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.

#### Neni 25

Procesverbali i secilit takim publik duhet të ruhen me të gjitha informatat të hollësishme që jepen për komunë, si dhe të gjitha propozimet e bëra nga anëtarët e publikut dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra. Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim, në ndonjë datë të mëvonshme duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit të takimit.

#### Neni 26

Komiteti për Politikë dhe Financa duhet ta shqyrtoj Procesverbalin e mbledhjes publike brenda 60 ditëve pas mbledhjes. Komiteti duhet ta shqyrtoj secilin propozim të dhënë gjatë mbledhjes dhe pas kryerjes së konsultimeve të nevojshme të bëjë rekomandimet e duhura në takimin e ardhshëm të Kuvendit Komunal.

### KAPITULLI- III - KOMITETET KËSHILLDHËNËSE

#### Neni 27

Kuvendi Komunal krijon komitetet këshilldhënëse sektoriale që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes. Në emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve, Kuvendi Komunal duhet të sigurojë një përfaqësim të gjerë nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë; në krijimin e këtyre komiteteve duhet të merret parasysh balancin gjinor dhe ato duhet të reflektojnë interesat e komuniteteve ekzistuese dhe/apo fshatrave brenda komunave.

#### Neni 28

Komitetet këshilldhënëse duhet të paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të Kuvendit Komunal; Ata gjithashtu duhet të monitorojnë ofrimin e shërbimeve në sektorët relevant dhe të bëjnë propozime për përmirësimin apo zgjidhjen e problemeve të identifikuara. Në kryerjen e detyrave të tyre, Komitetet Këshilldhënëse duhet të punojnë së bashku me Komitetet e Kuvendit në mënyrë të tillë që vendimet e Komiteteve të Kuvendit apo të Kuvendit të Komunës duhet të merren vetëm pas konsultimit me komitetin këshilldhënëse sektorial.

#### Neni 29

Anëtarët e Komiteteve Këshilldhënëse duhet të emërohen me mandat 3 vjeçar në baza të rregullta, ku 1/3 e anëtarëve duhet të emërohet çdo vit. Asnjë anëtarë i Komitetit

Këshillëdhënës nuk mund të shërbej më shumë se në dy mandate të njëpasnjëshme.

## PJESA E V :KUVENDII KOMUNËS, KRYESUESI DHE ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

### KAPITULLI –I- KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

#### Neni 30

Kuvendi i Komunës zgjedh kryesuesin e Kuvendit të Komunës, me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës,ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

#### Neni 31

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës .

#### Neni 32

32.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të thirren edhe nga çereku i antarëve të Kuvendit të Komunës dhe nga komitetet e Kuvendit të Komunës,në bazë të rregullave dhe procedurave ligjore.

32.2 Kuvendi Komunal miraton akte në kuadër të kompetencave dhe veprimtarisë së saj.Këto akte përfshijnë.Statutin,rregulloret e punës,rregulloret komunale dhe aktet tjera për funksionim efikas të Komunës.

#### Neni 33

Kryesuesi i Kuvendit ka dhe Zëvendëskryesuesin i cili i takon komunitetit joshumicë dhe zgjedhet në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

### KAPITULLI –II-: KOMITETET E PËRHERSHME

#### Neni 34

34.1 Pas konstituimit, Kuvendi i Komunës formon Komitetet e përhershme, në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

34.2 Numri i anëtarëve të Kuvendit në secilin komitetet duhet të përcaktohet nga Kuvendi i Komunës .

34.3 Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës anëtarët e komiteteve, që nuk janë anëtar të Kuvendit të Komunës.

## Neni 35

Në bazë të nenit 51 të Ligjit përi Vetëqeverisjen Lokale, Komuna themelon komitetet e përhershme që janë : Komiteti për Politik dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, dhe komitete tjera nëse konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësisë të tyre.

## KAPITULLI I –III- MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

### Neni 36

Kuvendi Komunal mban ,s'paku, 10 seanca në vit ,pesë prej të cilave duhen të mbahen gjat gjashtë muajve të par të vitit .Takimet e tjera thirren sipas nevojës.

### Neni 37

37.1 Të gjitha takimet duhet të thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me Rregulloren e Punës. Personi i cili thërret, apo udhëheqë takimet duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta, dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në të gjitha veprimet

37.2 Në takimet e tyre të para në secilin vit fiskal, Kuvendi i Komunës dhe secili komitet duhet t'i caktoj datat fikse në të cilat duhet të mbahen takimet e rregullta gjat vitit .Datat e mbajtjes së takimeve mund të ndryshohen me vendime pasuese.Takimet e tjera mund të thirren ,në çdo kohë

### Neni 38

38.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara që është objekt diskutimi përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.

38.2 Kuvendi i Komunës, nëpërmjet Zyrës Përgjegjëse për Informim, njofton publikun, të paktën 7 ditë pune, para mbledhjeve të rregullta ,ose, 3 ditë pune, para mbledhjeve të jashtëzakonshme, ndër të tjera, me mjetet e mëposhtme:

- 1 Shpallja publike në vendet më të frekuentura brenda territorit të Komunës
- 2 Median e shkruar dhe elektronike lokale , dhe
- 3 Faqen e Internetit të Kuvendit të Komunës

38.3 Njoftimet publike duhet të përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes

d) Rendin e ditës

38.4 Komitetet ,nëpërmjet Zyrës përgjegjëse për Informim njoftojnë publikun ,3 ditë pune ,para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimet publike përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes
- d) Rendin e ditës

#### Neni 39

Çdo anëtar i publikut i cili merr pjesë në Kuvendin Komunal dhe komiteteve të tij, me lejen e kryesuesit të takimit, mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet mbledhjes. Rregullorja e Punës mund të rregulloj të drejtat dhe veprimet e udhëheqësit të mbledhjes gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

#### Neni 40

40.1 Të gjithë anëtarët e Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të emrohen nga rradhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Anëtarësimi në çdo rast duhet të pasqyrojë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimitin gjinore në Kuvendin Komunal.

40.2 Antarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.

40.3 Numri i antarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të jetë, së paku 5 dhe më së shumti 9 anëtarë.

40.4 Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kryesohen nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës mbledhjet kryesohen nga njëri prej antarëve të këtij Komiteti.

#### Neni 41

41.1 Anëtarët e Komitetit për Kumnunitete emrohen nga Kuvendi i Komunës nga radhët e antarëve të Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesëve të komuniteteve pakicë.

41.2 Numri i antarëve të Komitetit për Komunitete duhet të jetë ,së paku 5 dhe më së shumti 9 anëtarë.

41.3 Komiteti për Komunitete në Komunë përbehët nga përfaqësuesit(së paku me nga një përfaqësues)të gjitha komunitete pakic që jetojnë në Komunë.Shumica e anëtarëve të këtij Komiteti përbehët nga komuniteti pakicë..

## KAPITULLI -IV – INFORMIMI PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS .

### Neni 42

42.1 Kërkesat për informata që kanë të bëjnë me çështjet komunale, të cilat bëhen nga anëtarët e Kuvendit Komunal të përcaktuara në Nenin 39 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, duhet të adresohen me shkrim tek zyrtari i përgjegjës i Komunës nga i cili kërkohen informatat.

42.2 Zyrtari përgjegjës i Komunës ,në afat prej 15 ditëve, duhet t'i përgjigjet me shkrim anëtarit ,ose anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

42.3 Një kopje e kërkesës dhe e përgjigjes duhet të futet në regjistër nga zyrtari përgjegjës Komunal i cili duhet ta shënoj datën e kërkesës së marrë dhe datën përgjigjes së dhënë.

42.4 Në qoftë se zyrtari Komunal konsideron se dhënja e ndonjë përgjegje për kërkesën apo pyetjen e veçant është e dëmshme për interesat e përbashkëta të qytetarve të Komunës,ai mund të refuzoj përgjigjen me shkrim ,duke paraqitur arsyet në dhenien e përgjegjes së till

## KAPITULLI –V- KOMPENZIMI I ANËTARVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

### Neni 43

Kompensimi për anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe anëtarëve të komiteteve, për punën që ata e bëjnë për komunën, duhet të mos tejkalojë rregullat e përcaktuara nga Qeveria Qendrore e Republikës së Kosovës.

### Neni 44

Anëtarët kompensohen për punën që ata e bëjnë për komunën, me një shumë për pjesëmarrje e cila rregullohet me Vendim të Kuvendit Komunal ,në harmoni me Udhëzimin Administrativ të organeve më të larta të Republikës së Kosovës.

## KAPITULLI-VI: KONFLIKTI I INTERESIT I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

### Neni 45

Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mundë të jenë edhe anëtarë të emëruar në Ekzekutivin dhe në Administratën e Komunës..

### Neni 46

Përjashtimet në procesin e vendimmarrjes, për shkak të konflikteve të interesit, bëhen në bazë të Nenit 37 dhe 38 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe duhet të shënohen në Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës .

#### Neni 47

Anëtarët që kanë konflikt të interesit në lidhje me një çështje të caktuar nuk kanë të drejtë të flasën e as të votojnë për çështjen për të cilën kanë konflikt të interesit dhe duhet të dalin nga salla e mbledhjes, atëherë kur diskutohet ajo çështje.

#### Neni 48

48.1 Nëse vijë deri te ndonjë konflikt potencial i interesit, pasi që është marrë vendimi, por para se të implementohet ai, vendimi duhet të suspendohet dhe çështja duhet të hetohet.

48.2 Nëse arrihet në përfundimin se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet tërësisht dhe duhet të bëhet një votim i ri, për marrjen e vendimit.

### KAPITULLI I –VII- MARRËDHËNIET NDËRKOMUNALE DHE PARTNERITETET

#### Neni 49

49.1 Kryetari i Komunës pas konsultimeve me Komitetin për Politikë dhe Financa, duhet të prezantoj rekomandimet për Kuvendin Komunal për marrëveshjet të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të Nenit 28 dhe 29 Ligjit për Vetëqeverisje Lokale

49.2 Kuvendi i Komunës vendos për lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësisë dhe pushtetit në bashkëpunim me njëra tjetrën

#### Neni 50

Kryetari Komunal, pas konsultimeve me Komitetin për Politikë e Financa duhet t'i prezantoj rekomandimet e tij tek Kuvendi Komunal në lidhje me marrëveshjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjeve komunale për mbikëqyrjen e shërbimeve publike lokale që ofrohen në më shumë se një Komunë

#### Neni 51

Kuvendi Komunal mund, që brenda kornizës së ligjit, të bëjë marrëveshje që të bashkëpunoj dhe të formoj partneritete me kuvendet tjera komunale, ashtu që të kryejnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

#### Neni 52

Kuvendi Komunal mund të bashkohet me kuvendet tjera komunale në asociacione , për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

## KAPITULLI -VIII- FINANCAT KOMUNALE DHE PROCEDURAT BUXHETORE

### Neni 53

53.1 Komuna ka buxhetin dhe financat e veta për të ushtruar kompetencat e veta. Buxheti dhe financat komunale rregullohen me Ligjin për Financat Lokale dhe aktet tjera.

53.2 Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të komunës janë përgjegjësi e Kryetari të Komunës,

53.3 Kryetari i Komunës këto përgjegjësi që kanë të bëjnë me administrimin financiar mund t'i bartë tek Nënkryetari i komunës, apo te ndonjë prej drejtorëve të drejtorive komunale

53.4 Kryetari i Komunës raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike financiare të Komunës dhe për zbatimin e planve investuese të Komunës, së paku, një herë në gjashtë muaj ,apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës.

## PJESA E IX: EKZEKUTIVI I KOMUNËS

### KAPITULLI – I - KRYETARI I KOMUNËS DHE ADMINISTRATA KOMUNALE

#### Neni 54

Kryetari i Komunës së Dragashit zgjedhet me mandat katër vjeçar,, të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës .

#### Neni 55

Kryetari i Komunës është udhëheqës i degës ekzekutive të komunës dhe zgjedhet drejtpërdrejtë nga qytetarët ,me të drejtë vote.

#### Neni 56

Kryetari i Komunës ushtron përgjegjësit e përcaktuara me nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

#### Neni 57

Përgjegjësit e tjera të kryetarit të Komunës janë :

I . Mbikëqyrë administrimin e përgjithshëm financiar të komunës.

II..Mbikëqyrë zbatimin të gjitha aktve juridike të aprovuara nga kuvendi i komunës

III.. Deleton përgjegjësi te antaret e Bordit të Drejtorve dhe mbikëqyr zbatimin përgjegjësi të deleguara.

IV . Propozon Kuvendit të Komunës ndryshime në lidhje me funksionin dhe numërin e drejtorëve apo drejtorive dhe funkconet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi:

V. I ofron propozime Kuvendit të Komunës për konstituimin,organizimin dhe koordinimin e organve komunale si dhe krijimin e institucionve dhe ndërmarrjeve;.

VI. Bënë caktimin apo ndarjen dhe koordinimin e përkoshem të punëve dhe përgjegjësi në mes të drejtorve sipas nevojës,duke pasur për bazë lëmin apo projektin e caktuar;.

VII. Dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara nga Kuvendi Komunës.

#### Neni 58

Ekzekutivi i Komunës-kryetari ,për të ushtruar përgjegjësit e caktuara me ligj dhe përgjegjësit e caktuara nga kuvendi i Komunës ndimohët nga Nënkryetari i Komunës,Nënkryetari i Komunës për Komunitete dhe Administrata Komunale-drejtorët komunal.

#### Neni 59

### NËNKRYETARI

Nënkryetari emrohët nga kryetari,për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga kryetari.Nënkryetari i ndihmon Kryetarit në ushtrimin e funksionve ekzekutive dhe vepron në emer të Kryetarit, në munges të tij.

#### Neni 60

### NËNKRYETARI PËR KOMUNITETE

Nënkryetari për Komunitete,emërohët dhe shkarkohët në bazë të Ligjit peri Vetëqeverisjen Lokale.

## KAPITULLI – II- DREJTORITË KOMUNALE

#### Neni 61

61.1 Administrata Komunale organizohet në drejtorate .Çdo drejtorat komunal menaxhohët nga drejtori.Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës.

62.2 Komuna ,për vitin fiskal përkatës,do të ketë 8 tetë drejtori dhe këto janë

1.Drejtorinë e Administratës dhe Personelit,

- 2.Drejtorin e Shëndetësis dhe Mirqenjes Sociale,
- 3.Drejtorin e Arsimit,
4. Drejtorin e Kulturës,Rinisë dhe Sportit,
- 5.Drejtorinë e Financave,Ekonomisë dhe Zhvillimit,
- 6.Drejtorin e Urbanizmit,Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
- 7.Drejtorin e Mbrojtjes,Shpëtimit dhe Shërbimve Publike,
- 8.Drejtorin e Bujqësisë,Turizmit,Zhvillimit Rural dhe Inspektion.

## Neni 62

### Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirqenies Sociale

Është përgjegjëse për:

- a. Ofrimin e kujdesit shëndetsor në komunë,në pajtim me dispozitat ligjore,
- b. Inspektimin e qendrave private të përkujesit primar shëndetësor,
- c. Vlerësimin e nevojave për shëndetësi primare,
- d. Vendosjen e objektve lokale për kujdesin primar shëndetësor,
- e. Zhvillimin e buxhetit bazuar në nevojat lokale dhe duke respektuar udhëzimet e MSH,
- f. Koordinon dhe mbikqyrë punën e QKMF,QMF dhe ambulancave,
- g.Operimin e qendrave për punë sociale dhe qendrave për mirëqenie sociale,
- h. Zhvillimin e planit strehimor për teritorin e komunës,
- i. Sigurimin e ofrimit të shërbimve sociale dhe familjare brenda teritorit,sipas standardve të përcaktuara nga MPMS,dhe
- j. Punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunë:

## Neni 63

### Drejtoria e Arsimit

Është përgjegjëse për:

- a. Planifikon zhvillimin e arsimit lokal dhe aftësimin e personelit mësimor,në bashkpunim të ngushtë me MASHT,
- b. Nxitë bashëpunimin midis personelit arsimor në raport me nxënësit dhe prinderit
- c. Siguron mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve shkollore dhe objekteve tjera përcjellëse me fondet e siguruar publike
- d. Nxjerrë rregulla disiplinore për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve në qdo institucion arsimor
- e. Merr pjesë në përzgjedhjen e drejtorve dhe mësuesëve të shkollave,
- f. Punë tjera të caktuara nga ana e Kryetarit të Komunës.

#### Neni 64

##### Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Është përgjegjëse për :

- a. Menaxhonnë mënyrë të drejtë me të gjitha objektet komunale të kulturës, sportit dhe rinisë ,
- b. Organizon takime me rëndësi kulturore, sportive dhe të rinisë për komunën,
- c. Organizon debate për zhvillimin e kulturës, sportit dhe rinisë në komunë,
- d. Mban shenime mbi të arriturat kulturore, sportive dhe rinore në komunë,
- e. Zhvillon planin për mbështetjen e aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore,
- f. Punë të tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.
- f. Punë tjera të cakura nga kryetari i Komunës.

#### Neni 65

##### Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit

Është përgjegjëse për :

- a. Hartimi i rregullorve komunale për çështje financiare,
- b. Ndhmon Kryetarin e Komunës në përgaditjen e projekt-buxhetit,
- c. Është përgjegjës për mbajtjen e llogarive dhe raportve financiare vjetore,
- d. Është përgjegjës për menaxhimin e thesarit nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës,
- e. Është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit,
- f. Përgatit procedurat dhe raportet e kontabilitetit,
- g. Jep këshilla profesionale nga fusha e buxhetit organve komunale
- h. Harton plane konkrete për zhvillimin e qendrueshem ekonomik të komunës,
- i. Harton plane konkrete për zhvillimin e industrisë zeytare,
- j. Harton planin për shfrytëzimin e burimeve ekonomike që janë brenda komunës,
- k. Krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarjve të vogëla dhe të mesme,
- l. Punë të tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

#### Neni 66

##### Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Është përgjegjëse për:

- a. Hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës në Koordinim me Ministrinë për Planifikim Hapësinor dhe Mjedisit,
- b. Hartimin e Planit të Zhvillimit Hapësinor, Urbanistik dhe Rural të Komunës, në koordinim me Ministrinë për Planifikim Hapësinor dhe Mjedisit,
- c. Harton kriteret për dhënien e lejes së ndërtimit,

- d. Harton kriteret për dhënien me qira të objekteve komunale dhe tokës ndërtimore të komunës,
- e. Mbanë evidencën për emertimet e vendbanimeve, rrugëve, sheshve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive brenda teritorit të komunës,
- f. Bënë vlersimin e pronës sipas kriterve dhe standardve të caktuara me legjislacionin në fuqi,
- g. Mbanë regjistrin e pronës së palujtëshme dhe regjistrin e tokës komunale,
- h. Bënë azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara,
- i. Mbron pronën komunale nga uzurpimet e ndryshme,
- j. Harton rregullore lokale për kontrollimin e mbeturinave dhe hedhurinave brenda teritorit të komunës,
- k. Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit,
- l. Kujdeset për trajtimin e ujrave të zeza dhe mbeturinave të ngurta,
- m. Punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

#### Neni 67

#### Drejtoria e Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike

Është përgjegjëse për :

- a. Shërbimet e zjarrëfikseve dhe emergjencës.
- b. Vështrimin, lajmrimin dhe alarmimin e popllësisë për kërcnim rreziku, organizimi dhe mirëmbajtja e mjetve për alarmim në sistemin unik të alarmimit si dhe funksionimi i ndërlidhjeve për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës ,në përputhje me sistemin unik të ndërlidhjes.
- c. Planifikimi dhe realizimi i masave mbrojtëse për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe vlersimi i rrezikut dhe hartimi i planve nga fatkeqësit natyrore dhe nga fatkeqësit tjera.
- d. Propozon themelimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim nga fatkeqësit natyrore dhe nga fatkeqësit e tjera, organizimi e komitetve, njesive dhe i shërbimeve të forcave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësit e tjera ,si dhe i forcave të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
- e. Sigurimi i mjetve urgjente për strehim të përkoshëm, si dhe realizimi i programve të aftësisimit.
- f. Harmonizimi i planve dhe përgaditjeve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë me komunat fqinje, ku do të bashpunojnë ndërmjet vete dhe mundë t'i bashkojnë mjetet dhe shërbimet e çështjeve të përbashkta në mbrojtje nga fatkeqësit natyrore dhe nga fatkeqësit e tjera.
- g. Organizimi, zhvillimi dhe udhëheqja e mbrojtjes personale dhe reciproke.
- h. Ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës, duke përfshir transportin lokal, mirëmbajtjen e rrugëve, furnizimin me ujë, ujsjellësin, kanalizimin, administrimin e mbeturinave.

## Neni 68

Drejtoria e bujqësisë, Turizmit, Zhvillimit Rural dhe Inspektion

Është përgjegjëse për :

- a. Hartimin e Planeve të Analizave Informatave dhe Programve, të cilat shërbejnë si bazë për përcaktimin e politikave në lëmin e bujqësisë,
- b. Kryen të gjitha punët për zhvillimin dhe përparimin e vazhdueshëm të bujqësisë e blegtorisë,
- c. Punët në komisione për përcaktimin e dëmeve në fusha,
- d. Përgatitjen e projektve-draftve të rregullorve ,urdhëresave dhe vendimeve komunale për rregullimin e çështjeve në bujqësi dhe blegtori, si në sektorin shoqëror ,po ashtu edhe atë privat,
- e. Mbajtja e evidencave mbi të gjitha sipërfaqet e palujtshmerisë dhe në lëmin e blegtorisë,
- f. Bën analiza mbi gjendjen në fushen e bujqësisë dhe blegtorisë,
- g. Dhenjen e pëlqimeve për regjistrim të mekanizmave bujqësor,
- h. Harton plane dhe programe për zhvillimin e turizmit ,sidomos atij nëpër fshatra,
- i. Harton plane dhe programe për zhvillimin e infrastrukturës dhe për zhvillimin rural në komunë,
- j. Bashkëpunon me vendbanimet rurale për përmirësimin dhe përparimin e infrastrukturës lokale.

67.1 Shërbimi i Inspektionit kryen këto punë :

- a .Bën kontrollin inspektues në aplikimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në lëmin e : punësimit dhe sigurisë në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarëve dhe ambientit të punës,tregëtisë,dhe shërbimeve të tjera hoteliere,të komunikacionit dhe kushtve të zhvillimit në:rrugë,bujqësisë,urbanizmit,ndërtimin e objektve,veterinës, shëndetësisë,sanitarisë,dhe mbrojtje nga epidemit e ndryshme.
- b.Aplikon të gjitha masat ndëshkuese të cilat janë të parapara me ligj dhe aktet nënligjore,
- c. Ushtron fletëparaqitje në gjykata për shkelje të dispozitave me të cilat bëhet kundërvajtje.

## Neni 69.

Drjetoria Administratës dhe Personelit

Është përgjegjëse për:

- a. Është përgjegjëse për të gjitha çështjet brenda institucionit të Komunës lidhur me personelin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.
- b. Njofton Kryetarin dhe Kuvendin e Komunës për çdo veprim të ndërmarr në kundërshtim me ligjin.

- c. Përgatit projekt rregulloret dhe projektvendimet në lëmin e administratës për ekzekutivin dhe Kuvendin e Komunë'
- d. Ofrimin e këshillave për kryetarin e Komunës, nëpunësve, mbi interpretimin dhe zbatimin e politikave, legjislacionit të institucionve të Republikës së Kosovës, si dhe rregulloreve me qëllim të sigurimit të funksionimit të të papenguar të punëve në kuadër të drejtorisë përkatëse .
- e. Identifikimi, planifikimin e nevojave për personel dhe punësimin e personelit,
- f. Zgjedh problemet e menaxhimit, që ka personeli në kuadër të drejtorisë,
- g. Kryen detyrat që i jep Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës

## PJESA E SHTATË SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

### Neni 70

Shërbimi Civil Komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese, për të pranuar shërbyes civil të komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

### Neni 71

Administrata komunale ka Udhëheqësin e Personelit i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës .

### Neni 72

Punësimi në shërbimin civil komunal mbikëqyret dhe rregullohet nga Shefi i Personelit për të siguruar që shërbimi civil reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik

### Neni 73

Shërbimi Civil Komunal ,si tërsi, duhet që të përmbaj proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuar.

### Neni 74

Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me udhëheqsin e personelit, do të emëroj një nën-komision detyrat e të cilit do të jenë këshillimi dhe konsultimi në përgjithësi për çështjet e resurëseve njerëzore që kanë të bëjnë me Shërbimin Civil Komunal, në veçanti me çështjet në vijim .:

- a) Kategorit dhe numrat për kategori
- b) Mbikëqyrja dhe përgjegjësit
- c) Detyrat dhe obligimet
- d) Delegimi i detyrave dhe obligimeve

- e) Rekrutimi dhe përzgjedhja
- f) Kushtet e pranimit
- g) Fillimi i punës në zyrë, puna provuese dhe lista rezervë
- h) Procedurat ankimore
- i) Procedurat e kundërshtimeve
- j) Trainimi dhe provimet
- k) Rishqyrtimi i paraqitjes dhe procedurat e vlerësimit
- l) Përparimi dhe sukcesi në karrierë
- m) Dosjet dhe referencat e stafit
- n) Kohëzgjatja e punësimit dhe njoftimi mbi pushimin e marrëdhënjes së puësimit
- o) Pagesat dhe shpërblimet tjera
- p) Pagesa për udhëtim dhe mëditjet
- q) Pushimi
- r) Rregullat e Shërbimit Civil Komunal

**PJESA E TETË :**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 75

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave Statutare me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Llokale ,dispozitat e Ligjit mbizotrojnë .

Neni 76

Ky Statut hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe nëshkrimit të tijë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Neni 77

Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti pushojnë të vlejnjë të gjitha dispozitat dhe aktet komunale të mëparshme ,në ato pjesë ku janë në kundërshtim me Statutin e Komunës.

Neni 78

Me aprovimin e këtij Statuti ,të gjitha aktet tjera të Komunës, brenda tre muajve, do të harmonizohen me Statutin në fuqi.

Neni 79

Interpretimi autentik i këtij Statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës

**01 Nr.06-103/1**  
**Dt.11.09.2008**

**KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH**  
**Kryesuesi**  
**Salim Jenuzi**

---